



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3562/prot.
11

Shkodër, më 27 . 10 2025

Lënda: Njoftim për vende të lira pune

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të radhës, për dy vende të lira pune në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Drejtoria e Bibliotekës Shkencore.

Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof. dr. Tonin Gjaraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 382 Prot

Shkodër, më 27. 10 .2025

N J O F T I M


Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi **për 2 (dy) vende vakante**, kategoria staf ndihmës akademik me karakter administrativ, pranë Drejtorisë së Bibliotekës Shkencore, **pozicioni "Përgjegjës i Sektorit Bibliotekarë-Arkivistë"** dhe **pozicioni "Bibliotekarë-Arkivistë"** në Bibliotekën Austriake në BUSH.

Përgjegjës i Sektorit Bibliotekarë- Arkivistë

I. Kritere të përgjithshme:

Kandidatët për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit Bibliotekarë- Arkivistë", duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

- a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. Të zotërojnë aftësi të profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- c. Të kenë aftësi të punës në grup dhe të komunikimit profesional;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
- f. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- g. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjininie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brenda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- h. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.



II. Kriteret specifike:


Kandidatët për pozicionin, “Përgjegjës i Sektorit Bibliotekarë- Arkivistë”, duhet të plotësojnë këto kriteret specifike:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën e Shkencave Shoqërore ose Humanitete, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose program studimi 4- vjeçar*). **Kriteri minimal i diplomës për efekt kandidimi në këtë pozicion është “Master i Shkencave”.**
Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse.
2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të përgjithshme në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve **jo më të ulët se 7.5 (shtatë pikë pesë).**
3. Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), me nivel jo më të ulët se B1, (notë jo më të ulët se 7), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
4. Të kenë jo më pak se 3 vite eksperiencë punë në administratën publike.
5. Preferohet që kandidatët:
 - të kenë kryer specializime apo kualifikime në fushën përkatëse ku konkuron;
 - të kenë eksperiencë pune të ngjashme;
 - të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
 - të kenë aftësi të mira kompjuterike;

III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Bibliotekarë- Arkivistë”, duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dokumentet si më poshtë:

- a. Fletë përmbledhëse të dokumentacionit të dorëzuar.
- b. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
- c. Jetëshkrim (CV) me foto personale sipas formatit standart (europass);
- d. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSC; sistemi 4-vjeçar; ose DIND) në fushat e lartpërmendura dhe listën përkatëse të notave, të noterizuara. *Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.*
- e. Rekomandim ose leter referencë nga punëdhënësi i fundit.
- f. Dëshmi të gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore (origjinale ose kopje të noterizuara).

- 
- g. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjykate dhe vërtetim nga prokuroria të lëshuara brënda 3 muajve të fundit;
 - h. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë (lëshuar brënda 3-muajve të fundit);
 - i. Kopje e noterizuar e librezës së punës dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë nëse kandidati është ose ka qënë në marrëdhënie pune në administratën publike.
 - j. Deklaratë personale që dëshmon se kandidati nuk ka lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen dhe që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar).
 - k. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

Bibliotekarë- Arkivistë (në Bibliotekën Austriake në BUSH)

I. Kritere të përgjithshme:

Kandidatët për pozicionin “Bibliotekarë- Arkivistë”, në Bibliotekën Austriake në BUSH, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

- a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. Të zotërojnë aftësi të profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- c. Të kenë aftësi të punës në grup dhe të komunikimit profesional;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- f. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
- g. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar).
- h. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.

II. Kriteret specifike:

Kandidatët për pozicionin, “Bibliotekarë- Arkivistë”, në Bibliotekën Austriake në BUSH, duhet të plotësojnë këto **kritere specifike**:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën e Shkencave Shoqërore ose në Gjuhën Gjermane, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; Program studimi i integruar i ciklit të dytë; Program i nivelit të dytë; ose program studimi 4- vjeçar*). **Kriteri minimal i diplomës për efekt kandidimi në këtë pozicion është “Master Profesional”.**

Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse.

2. Kandidatët duhet të kenë notë mesatare të përgjithshme në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve **jo më të ulët se 7(shtatë).**

3. Në rastet kur kandidati nuk ka mbaruar studimet e larta në “Gjuhën Gjermane”, duhet të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës gjermane, të vërtetuar me dëshmi të gjuhës së huaj “ Gjuhë Gjermanë”, në nivelin C1.

4. Të kenë jo më pak se 1 vit eksperiencë pune në administratën publike;

5. Preferohet që kandidatët:

- të kenë kryer specializime apo kualifikime në fushën përkatëse ku konkuron;
- të kenë eksperiencë pune të ngjashme;
- të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
- të kenë aftësi të mira kompjuterike;

III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin “Bibliotekarë- Arkivistë”, në Bibliotekën Austriake në BUSH, duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dokumentet si më poshtë:

- a. Fletë përmbledhëse të dokumentacionit të dorëzuar.
- b. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
- c. Jetëshkrim (CV) me foto personale sipas formatit standart (europass);
- d. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSC; DIND; Program studimi i nivelit të dytë; ose të sistemit 4- vjeçar) në fushat e lartpërmendura dhe listën përkatëse të notave, të noterizuara. *Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.*
- e. Rekomandim ose leter referencë nga punëdhënësi i fundit.
- f. Dëshmi të gjuhës së huaj Gjermane në nivelin C1, të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore (origjinale ose kopje të noterizuara).
- g. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjykate dhe vërtetim nga prokuroria të lëshuara brënda 3 muajve të fundit;

- h. Rëport mjeko-ligjor për aftësi në punë (lëshuar brënda 3-muajve të fundit);
- i. Kopje e noterizuar e librezës së punës dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë nëse kandidati është ose ka qënë në marrëdhënie pune në administratën publike.
- j. Deklaratë personale që dëshmon se kandidati nuk ka lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen dhe që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- k. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

Legjislacioni rreth të cilit do zhvillohet faza e dytë e konkurimit për të dy pozicionet, (intervista me gojë), do të bazohet në:

1. Ligj Nr. 7961, datë 12. 7. 1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
3. Ligji Nr.8576, datë 3.2.2000 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
4. Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", miratuar me Urdhër të MAS nr 366, datë 05. 07. 2018, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

V.O:

- Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë** dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, me mbishkrimin "Aplikim për punë", drejtuar Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", brënda **14 ditëve kalendarike** nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara apo mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë shpallje, (me përjashtim të kriterëve të përcaktuara si preferenciale) përbën shkak për skualifikimin e kandidatëve.
- Konkursi do të zhvillohet në dy faza:

Faza I: Vlerësimi i dokumentacionit dhe;

Faza II. Intervista me gojë.

- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc për kualifikimin apo skualifikimin e tyre.
- Ankimimet mund të bëhen brenda 5 (pesë) ditëve punë nga shpallja e rezultatit.

REKTORI

Prof. dr. Tonin Gjural
